



This programme is funded  
by the European Union



**Tryezë Pune me temë “Vëzhgimet Përfundimtare të Komitetit CEDAW dhe raporti i GREVIOs për Shqipërinë-plane veprimi për organizatat jofitimprurëse që punojnë kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.**

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) organizoi tryezën me temë, “Vëzhgimet Përfundimtare të Komitetit CEDAW dhe raporti i GREVIOs për Shqipërinë-plane veprimi për organizatat jofitimprurëse që punojnë kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, me pjesëmarrjen e 70 përfaqësuesëve nga organizatat e shoqërisë civile, institucionet përgjegjëse dhe aktorë të tjerë.

Kjo tryezë u organizua në kuadrin e projektit “Ngritja e një rrjeti të organizatave jofitimprurëse për një zbatim më të mirë të standardeve ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore në Shqipëri”, zbatuar nga QNL. Projekti financohet nga Komisioni Evropian dhe zbatohet me mbështetjen e UN WOMEN

Punimet e tryezës u hapën nga Prof.Dr. Aurela Anastasi, Drejtore Ekzekutive e QNL-së.

Më tej tryeza u përshëndet përmes fjalës përshëndetëse dhe diskutimeve të Znj. Vasilika Hysi, Nënkryetare e Kuvendit të RSH-së, Zj.Erinda Ballanca, Avokate e Popullit, Zj.Enkelejda Bregu, Përfaqësuese e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Zj.Agustela Nini Pavli, Përfaqësuese e UN WOMEN dhe Zj.Merita Xhafa, përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Zj.Vasilika Hysi, nën kryetare e Kuvendit të Shqipërisë ndau me pjesëmarrësit miratimin nga Kuvendi të Rezolutës “Për dënimin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe rritjen e efektshmërisë së mekanizmave ligjorë për parandalimin e saj”, ngritjen e nënkomisionit të përhershëm parlamentar “Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas”, pranë Komisionit të përhershëm për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, hartimin nga ky nënkomision të një plani veprimi për zbatimin e rekomandimeve të GREVIOs, CEDAW, propozimin e ndërhyrjeve ligjore të nevojshme që ndihmojnë në përmirësimin e trajtimit të grave dhe vajzave dhe rritjes së sigurisë së jetës së tyre si edhe bashkëpunimin me organizatat e rrjetit për monitorimin e standardeve ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave. Gjithashtu Zj. Hysi ndau me pjesëmarrësit miratimin e Rezolutës “Për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të axhendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara”.

Zj.Erinda Ballanca, Avokate e Popullit u ndal në rolin e institucionit të Avokatit të Popullit në parandalimin e dhunës kundër grave, nevojën për edukim, sensibilizimin për fenomenin e dhunës

kundër grave dhe dhunës në familje, duke ndërmarrë përpjekje për luftimin e këtij fenomeni edhe në zonat më pak të zhvilluara.

Prezantimi i objektivave të projektit dhe qasja me çështjet e paraqitura nga Komiteti CEDAW dhe GREVIO në raportet për Shqipërinë u prezantua nga Av. Aurela Bozo.

Disa nga çështjet e raportit të GREVIOs për Shqipërinë, që u diskutuan në këtë tryezë ishin:

- marrja e masave nga shteti shqiptar të cilat adresojnë të gjitha format e dhunës kundër grave,
- rritja e rolit të institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si mbrojtëse të viktimave të dhunës kundër grave,
- adresimi i diskriminimit ndërsektorial,
- forcimi i strukturës kundër dhunës ndaj grave, bashkëpunimi ndërinstytucional në Mekanizmin e Referimit,
- sigurimi i fondeve për shërbime sociale nga bashkitë për viktimat e të gjitha formave të dhunës kundër grave,
- roli i personelit shëndetësor dhe raportimi i rasteve të dhunës ndaj grave,
- rritja e numrit dhe kapaciteteve të strehëzave, rritja e aksesit të grupeve vulnerabile në strehëza,
- qëndrueshmëria financiare e linjës së re kombëtare të këshillimit,
- mbrojtja e viktimave të dhunës seksuale,
- miratimi i masave për të garantuar të drejtën e viktimave në kompensim,
- parashikimi i formave të dhunës ndaj grave si sterilizimit të detyruar dhe gjymtimi i organeve gjentile femërore si vepra penale,
- zhvillimi i procedurave të standardizuara për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut,
- ekzekutimi efektiv i urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrave të mbrojtjes,
- ngritja e një sistemi efektiv të ndihmës juridike për viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave,

Ngritja dhe forcimi i një rrjeti organizatash jofitimprurëse që punojnë kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe diskriminimit ishte prezantimi i radhës që u mbajt nga Zj. Ines Leskaj, Drejtore Ekzekutive, Rrjeti AWEN. Zj. Leskaj theksoi eksperiencat e mëparshme të OJF-ve dhe rrjeteve mbi të cilat do të mbështetet ngritja e rrjetit mbi monitorimin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare.

Pas prezantimit të Raporteve, pjesëmarrësit ngritën çështje të rëndësishme për zbatimin e standardeve të tyre. Disa nga këto çështje ishin: roli i medias në parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna kundër grave dhe dhunës në familje, roli i rrjetit të OJF-ve në zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit, përfshirja e temave të barazisë gjinore dhe dhunës kundër grave në kurrikulat e Fakulteteve të ndryshme në Universitetin e Tiranës dhe universitete të tjera, mungesa e informacionit të grupeve vulnerabile në lidhje me të drejtat e tyre, rritja e kapaciteteve të OJF-ve në monitorimin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare dhe koordinimi i punës në grupe të OJF-ve të rrjetit, me qëllim monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të GREVIOs dhe Komitetit CEDAW, etj. Përfaqësues të organizatave të ndryshme pjesëmarrëse shprehën gatishmërinë për të qenë pjesë e rrjetit të organizatave jofitimprurëse për një zbatim më të mirë të standardeve ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore në Shqipëri.

## **ORGANIZATAT DHE INSTITUCIONET PJESËMARRËSE:**

Forumi i Gruas Elbasan,  
Komiteti Shqiptar i Helsinkit,  
Qendra Komunitare Sot për të Ardhmen,  
Qendra Psiko Sociale “Vatra”,  
Alo 116,  
Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem në Tiranë,  
Shoqata e Grave me Probleme Sociale,  
Stop Aids, AIPA,  
Shoqata Jona Sarandë,  
Qendra Të ndryshëm dhe të Barabartë,  
AWEN,  
AIPA,  
Qendra për të Drejtat e Grave Rome,  
ACPD,  
Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale,  
UNCHR,  
Qendra Res Publika,  
Shoqata Unë Gruaja Pogradec,  
Shoqata e Personave që Jetojnë me HIV/AIDS,  
Shoqata Gruaja tek Gruaja Shkodër,  
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim,  
Rrjeti i Grave Barazi në Vendimmarrje,  
Ad Litem,  
QSHPLI,  
Roma Education Fund,  
Shoqata Refleksione,  
Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut,  
Roma Active Albania  
IPSED,  
EU DELEGATION  
UN WOMEN,  
Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim PNUD,  
UNCHR,  
Kuvendi i Shqipërisë,  
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,  
Ministria e Punëve të Jashtme,  
Institucioni i Avokatit të Popullit  
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,  
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës,  
Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Tiranë

**Foto nga aktiviteti.**



*Foto nga aktiviteti*



*Foto nga aktiviteti*



*Foto nga aktiviteti*



*Foto nga aktiviteti*